

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Prokuroria e Përgjithshme

Ministria e Rendit Publik

Nr. 760, date 11.04.2003

Nr. 309, date 09.04.2003

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR

**PËRDORIMIN E METODAVE SPECIALE TE HETIMIT
TE KRIMEVE KUNDËR DROGËS**

Ne mbështetje te nenit 102. pika 4 te Kushtetutës: te nenit 8, pika 2 te Ligjit nr. 8737, date 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë" dhe te nenit 7 te Ligjit nr. 8750, date 26.03.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut te substancave narkotike ose psikotrope".

UDHËZOJMË:

1. Metoda Speciale te Hetimit, ne zbatim te këtij Udhëzimi te Përbashkët. do te konsiderohen:

- a. Metoda e blerjes se stimuluar;
- b. Metoda e dorëzimit te kontrolluar;
- c. Metoda e punonjësit nen mbulim;
- d. Metoda e punonjësit te policisë se infiltruar.

2. Metodat Speciale te Hetimit kane për qellim gjurmimin, identifikimin dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale te te gjithë personave (korrierëve, blerësve, organizatoreve, financuesve etj.) dhe/ose organizatave kriminale te përfshira ne trafikun e organizuar ndërkombëtar te lendeve narkotike.

3. Metodat Speciale te Hetimit lejohen te përdoren vetëm ne rastet kur:

- a. Ka çështje te rëndësishme te trafikut ndërkombëtar te organizuar te lendeve narkotike. psikotrope dhe prekusoreve te tyre;

- b. Nuk ka mundësi të tjera për identifikimin, grumbullimin e provave dhe dokumentimin e personave të implikuar në këtë veprimtari;
 - c. Garantohet plotësisht realizimi i qëllimit dhe moscenimi i jetës dhe shëndetit të personave pjesëmarrës në këto metoda:
4. Metoda e blerjes së stimuluar përveç çfarë është parashikuar në pikën 3 të këtij Udhëzimi të Përbashkët, realizohet edhe kur plotësohen këto kushte:
 - a. Lënda narkotike, psikotrope dhe prekursorëve të tyre janë gjendje në vend dhe nuk kërkohet importimi i tyre;
 - b. Lënda narkotike, psikotrope dhe prekursorët e tyre janë të destinuara për tregun e paligjshëm;
 - c. Mostrat e këtyre lendeve të siguruar nga punonjësit e policisë gjyqësore të Shërbimit të Luftës Kundër Drogës apo nga informatori i autorizuar prej tyre, të vërtetohen se janë të tilla mbi bazën e një akti ekspertimi të dhënë me pare;
 5. Për realizimin e metodës së blerjes së stimuluar prej zyrave rajonale të luftës kundër drogës kryhen këto veprime:
 - a. Shefi i zyrës përkatëse rajonale të luftës kundër drogës, me miratim të drejtorit të policisë së qarkut bën kërkesë me shkrim brenda 24 orëve drejtuesit të prokurorisë të rrethit ku do të bëhet veprimi;
 - b. Njoftohet menjëherë me shkrim Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës për kërkesën e bere.
 - 5.1. Kërkesa me shkrim për prokurorinë duhet të përmbajë:
 - a. Bazueshmerine ligjore për përdorimin e metodës së blerjes së stimuluar;
 - b. Të dhënat e plota mbi situatën, për personat e njohur e të implikuar si dhe rezultatet që kërkohen të arrihen;
 - c. Identitetet e punonjësit të policisë në mbulim apo informatorit që do të marrin pjesë në operacion si dhe veprimet që ata do të kryejnë;
 - d. Identitetet e tjera që do të përdoren për kamuflim të punonjësve të policisë në mbulim;
 - e. Llojin e lendes narkotike, psikotrope ose prekursorëve të tyre.
 6. Në rastet kur metoda së blerjes së stimuluar do të kërkohet dhe realizohet nga Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës, Shefi i këtij Shërbimi, me miratim të Drejtorit të Policisë Kriminale bën kërkesë me shkrim Prokurorisë së Përgjithshme, sipas pikës 5.1 të këtij Udhëzimi të Përbashkët.
 7. Kur gjykohet pamundësia e realizimit të metodës së blerjes së stimuluar për mosplotësim të kërkesave të përcaktuara në pikën 3 dhe 4 të këtij Udhëzimi të Përbashkët sipas rastit Shefi i Shërbimit Qendror të Luftës Kundër Drogës ose Drejtori i Policisë Kriminale, vendosin anulimin e kryerjes së veprimeve.

7.1. Ne rastet e anulimit te kryerjes se metodës se blerjes se stimuluar njoftohet menjëherë prokurori përkatës duke argumentuar arsyet e marrjes se këtij vendimi.

8. Prokurorit te cilit i është drejtuar kërkesa. pasi shqyrton materialet e çështjes dhe kërkesën, brenda 24 orëve është i detyruar te vendose për kryerjen ose jote metodës se blerjes se stimuluar.

9. Me marrjen e nga prokurori përgjegjës për lejimin e realizimit te metodës se blerjes se stimuluar. Shërbimi Qendror i Luftës Kundër drogës harton planin e operacionit. te cilin e miraton Drejtori i Përgjithshëm i Policisë se Shtetit.

9.1. Ne planin e operacionit duhet te parashikohen sidomos:

- a. Drejtuesit i operacionit dhe ndihmësi i tij;
- b. Grupi i mbështetjes për garantimin e jetës se punonjësve te policisë ne mbulim dhe/ose informatorit qe marrin pjese ne operacion;
- c. Punonjës in e policisë qe siguron ne veprimet e tij punonjës it e policisë ne mbulim;
- d. Personin/personat qe do te mbajnë paratë;
- e. Grupi i sigurimit për personin/personat qe do te mbajnë paratë;
- f. Mjetet e ndërlidhjes. automjetet dhe te gjitha pajisjet e nevojshme për aplikimin e metodës;
- g. Mënyrat e legjendimit për te gjithë veprimtarinë e punonjës it te policisë ne mbulim dhe/ose informatorit;
- h. Detyra te detajuara për çdo pjesëmarrës ne përdorimin e metodës se blerjes se stimuluar;
- i. Mënyrat e ndërlidhjes e re komunikimit te re gjithë pjesëtareve ne operacion.

10. Ne rastet kur do te gjykohe e nevojshme se zhvillimi i mëtejshëm i operacionit paraqet rrezik për jetën e pjesëmarrësve ose për te dështuar operacioni, drejtuesi i tij e ndërpret operacionin, duke informuar menjëherë prokurorin përgjegjës si dhe Drejtorin e Policisë Kriminale.

11. Dorëzimi i kontrolluar, sipas vendit qe realizohet mund te jete:

a. “i brendshëm” kur pika e nisjes dhe destinacioni I një ngarkese me lende narkotike, psikotrope ose prekursoreve te tyre është brenda territorit te Republikës se Shqipërisë.

- b. "Ne hyrje", kur ngarkesa me këto lende është konstatuar dhe nisur nga një vend i huaj me destinacion për ne Shqipëri.
- c. "Ne dalje" kur ngarkesa nisët nga territori Shqiptar dhe destinacioni i saj janë shtete të tjera:

12. Metoda e dorëzimit të kontrolluar përveç çfare është parashikuar në pikën 3 të këtij Udhëzimi të Përbashkëta përdoret vetëm kur realizohet sigurimi i kontrollit të plote e të vazhdueshëm të ngarkesës së lendes narkotike, psikotrope ose prekursorëve të tyre.

13. Sherbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës, për të kryer një dorëzim të kontrolluar i dërgon Prokurorit të Përgjithshëm kërkesë me shkrim nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të lejuar zhvillimin e këtij veprimi.

14. Kërkesa me shkrim për Prokurorin e Përgjithshëm duhet të përmbajë:
- a. Bazueshmerine ligjore për kryerjen e metodës së dorëzimit të kontrolluar;
 - b. Të dhëna mbi situatën për personat e njohur e të implikuar si dhe rezultatet që kërkohen të arrihen;
 - c. Identitetin e punonjësit të policisë në mbulim apo të informatorit që do të marrin pjesë në operacion;
 - d. Veprimet që ata do të kryejnë gjatë operacionit;
 - e. Llojin e lendes narkotike, psikotrope ose prekursorëve të tyre;
 - f. Kërkesat e shteteve që do të kërkojnë kryerjen e këtij veprimi për ngarkesat në hyrje dhe tranzit.

15. Në rast se Prokurori i Përgjithshëm nuk e gjen të bazuar zhvillimin apo vazhdimin e dorëzimit të kontrolluar urdhëron moskryerjen e dorëzimit të kontrolluar dhe njofton menjëherë Sherbimin Qendror të Luftës Kundër Drogës, i cili ndërpret zhvillimin e veprimit, duke kryer njëkohësisht veprimet e nevojshme procedurale.

15.1. Në rastet kur për kryerjen e këtij operacioni janë të interesuar struktura partnere të huaja, Sherbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës bën komunikimet e nevojshme.

16. Para zhvillimit të dorëzimit të kontrolluar përgatitet plani i operacionit, i cili duhet të përmbajë:
- a. Drejtuesin e operacionit dhe ndihmësin e tij;
 - b. Grupin e vëzhgimit;

- c. Mjetet e ndërlidhjes, automjetet dhe te gjitha pajisjet e nevojshme për përdorimin e metodës;
- d. Detyrat e detajuara për çdo pjesëmarrës ne përdorimin e metodës se dorëzimit te kontrolluar;
- e. Mënyrat e ndërlidhjes e komunikimit te te gjithë pjesëtareve ne operacion
- f. Grupet qe do te marrin pjese për kryerjen e arrestimeve te mundshme.

17. Me miratim te prokurorit përgjegjës. ne fillim te përdorimit te dorëzimit te kontrolluar dhe kur mendohet se ekzistojnë mundësitë se ngarkesa mund te humbasë nga kontrolli, mund te kryhet zëvendësimi i saj me lende te tjera.

18. Drejtuesi i operacionit te kryerjes se dorëzimit te kontrolluar mund te ndërpresë me iniciative zhvillimin e mëtejshëm te tij, kur gjate veprimeve dalin rrethana qe rrezikojnë jetën apo shëndetin e pjesëmarrësve ne operacion ose te humbjes se kontrollit mbi ngarkesën e lendes narkotike, psikotrope ose prekursorëve te tyre.

18.1. Ne te gjitha këto raste, pas ndërprerjes se metodës se dorëzimit te kontrolluar, nga drejtuesi i operacionit njoftohet menjëherë prokurori përgjegjës dhe Drejtori i Policisë Kriminale.

19. Kryerja dhe zhvillimi i operacioneve te blerjes se stimuluar dhe dorëzimit te kontrolluar shoqërohen me filmime, fotografime si dhe përgjime, sipas kërkesave te Kodit e Procedurës Penale.

20. Përdorimi i metodës se punonjësit te Policisë se Shtetit te infiltruar behet vetëm ne rastet kur ka filluar një procedim penal dhe plotësohen kushtet e përcaktuara ne piken 3 te këtij Udhëzimi te Përbashkët.

21. Për përdorimin e metodës se punonjësit te policisë te infiltruar Sherbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës bën një plan masash te hollësishëm. te miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë se Shtetit. Plani i masave duhet te përmbaje:

- a. Mënyrën e legjendimit te punonjësit te policisë te infiltruar;
- b. Mjetet e ndërlidhjes dhe te komunikimit;
- c. Mënyrën e zgjidhjes se situata ve te papritura qe mund te krijohen;
- d. Mënyrën dhe format e realizimit te kontrollit te veprimtarisë se tij.

22. Sherbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës raporton tek prokurori përgjegjës me shkrim dhe ne mënyre periodike për veprimtarinë e punonjësit te policisë te infiltruar. Ne raste te veçanta, këto raportime mund te bëhen edhe me goje, por brenda 24 orëve ky komunikim dokumentohet ne një informacion me shkrim.

23. Me miratim te Drejtorit te Përgjithshëm te Policisë se Shtetit punonjësit e policisë te infiltruar dhe ata qe shërbejnë si punonjës policie ne mbulim pajisen edhe me dokumente identifikimi me gjeneralitete te tjera.

24. Shpenzimet për zhvillimin e operacioneve te blerjes se simuluar, dorëzimit te kontrolluar si dhe për aktivitetin e punonjëseve te policisë nen mbulim e te infiltruar, përballohen sipas akteve normative te miratuara nga Ministri i Rendit Publik.

25. Me këtë Udhëzim te Përbashkët te njihen prokuroret dhe punonjësit e Policisë se Shtetit.

26. Për zbatimin e këtij Udhëzimi te Përbashkët ngarkohen prokuroret dhe punonjësit e policisë te shërbimit te luftës kundër drogës.


27. Për kontrollin e zbatimit te këtij Udhëzimi te Përbashkët, sipas perkatesise te detyrave qe kane, ngarkohen Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë se Shtetit.

28. Ky Udhëzim i Përbashkët hyn ne fuqi menjëherë.

PROKURORI I PERGJITHSHEM



MINISTRI I RENDIT PUBLIK



Luan RAMA

